

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kontrollet e makinave luksoze “ngjiten” në veri, sekuestrohet “Rolls-Royce” i lezhjanit që jeton në Angli (PAMJE-DETAJE)
ADRESA	https://newsbomb.al/aktualitet/kontrollet-e-makinave-luksoze-ngjiten-ne-veri-sekuestrohe-t-rolls-royc-i400869
BURIMI	newsbomb.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	10 shtator 2026, 10:29:10 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	10 shtator 2026, 10:03:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	4cc6dc827936a1b75eabca96b440e0de6003ec2f38ca4b59ed321b0c965b25fd
TEKSTI	8a82fe450d73f162af7be7bf0ac5119e93aa955d747fe2ec75f9b865c113163c
PAMJA	3d7b16403edd979edfd73af602f8cfc8638515f70d6a7d02c9d36c194d12d676

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	327afb80b1d09ceaf238225a315ccf346c34998cc6301d87a5c16feeb9e9a241
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	d35bf96e2e2477ebd2106ee1d9fe097322df12c64ad1eb4eebbbfad377b409db
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/327afb80b1d09ceaf238225a315ccf346c34998cc6301d87a5c16feeb9e9a241>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

12 numrat e parë FALAS!
Version PDF

Abonohu te Revista

Kreu Politikë Aktualitet Ekonomi Kulturë & Art Rajon Sport Bota Showbiz SocialBomb



Çështjet kryesore

Arrestohet Ergys Agasi

"Retreat"-i i qeverisë në Pogradec!

SPAK godet grupin e Eldi Dizdarit dhe Dritan Gjikës

Aktualitet

10 Shtator 2026, 12:03

Kontrollet e makinave luksoze "ngjiten" në veri, sekuestrohet "Rolls-Royce" i lezhjanit që jeton në Angli (PAMJE-DETAJE)



Shkruar nga Newsbomb



Foto nga kontrollet

Policia e Lezhës ka ushtruar kontrolle të intërsishme ndaj automjeteve luksoze, me qëllim evidentimin dhe verifikimin e mjeteve që dyshohet se mund të jenë përfituar nga veprimtari kriminale, si dhe parandalimin e trafikimit të tyre.

Në kuadër të këtyre kontrolleve, strukturat për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Financiare, në bashkëpunim me shërbimet e Forcës së Posaçme Operacionale dhe të Policisë Rrugore, kanë kontrolluar një automjet luksoz të konstatuar në qytetin e Lezhës.

Gjatë kontrollit, shërbimet e policisë ka kryer verifikime lidhur me origjinën e automjetit, historikun e blerjes, shitjes dhe posedimit të tij, si dhe mbi pronësinë dhe burimin e të ardhurave me të cilat është blerë.

Sipas njoftimit të policisë, një automjet luksoz tip "Rolls-Royce" është bllokuar administrativisht për mungesë dokumentacioni. Ndërkohë, ka nisur edhe hetimi pasuror ndaj pronarit të automjetit, shtetasit F. M., banues në Mbretërinë e Bashkuar.

Kujtojmë se kontrollet e makinave luksoze në Lezhë janë ushtruar vetëm pak ditë pasi efektivat e Tiranës ndaluan disa mjete me kosto të majme, të cilat u janë nënshtruar verifikimeve për origjinën dhe burimin e parave me të cilat janë blerë.

Revista



Abonohu tani dhe lexoje >

Lajmet e fundit



Bota

Trump "hap thesin": Do dërgoj 5 mijë dollarë për çdo amerikan, nëse fiton Partia Republikane



Politikë

Sali Berisha prej ditësh në Amerikë, e ngarkuara me punë e ambasadës së SHBA-së takim "kokë më kokë" me Gazment Bardhin (VIDEO)

Zbulu më shumë artikuj >



Njoftimi i Policisë:

Lezhë/kontrolli i përqendruar ndaj automjeteve luksoze, në fokus verifikimi i origjinës së tyre dhe i burimit të pasurisë.

Bllokohet 1 automjet tip "Rolls-Royce", nis hetimi pasuror për pronarin e tij.

Strukturat e Policisë së Lezhës kanë intensifikuar kontrollet ndaj automjeteve luksoze, me qëllim evidentimin dhe verifikimin e mjeteve që dyshohet se mund të jenë përfituar nga veprimtaritë kriminale, si dhe parandalimin e trafikimit të tyre.

Në kuadër të këtyre kontrolleve, strukturat për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Financiare, në bashkëpunim me shërbimet e Forcës së Posaçme Operacionale dhe të Policisë Rrugore, kanë kryer kontrollin e një automjeti luksoz që kanë konstatuar në qytetin e Lezhës.

Nga Seksioni për Hetimin e Krimeve Ekonomike e Financiare janë kryer verifikime lidhur origjinën, historikun e blerjes, shitjes dhe posedimit të automjetit, mbi pronësinë dhe burimin e të ardhurave me të cilat është blerë automjeti.

Në përfundim të verifikimeve, është kryer bllokimi administrativ i automjetit "Rolls-Royce" për mungesë dokumentacioni dhe ka nisur hetimi pasuror për pronarin e automjetit, shtetasin F. M., banues në Mbretërinë e Bashkuar.

Policia e Lezhës do të vijojë kontrollet e përbashkëta dhe verifikimet ndaj automjeteve luksoze, me qëllim evidentimin e pasurive me burim kriminal dhe goditjen e pastrimit të produkteve të veprimtarive kriminale.

Sondazh

Poll

Lexo gjithashtu



🕒 E Enjte 12:22

Shpërthimi tek "Eida" në Brryl, çfarë DËSHMUAN tre punonjësit e plagosur: Po

furnizonim një makinë me gaz kur...



Aktualitet

16 protestues në pranga pas protestës së djeshme, Policia del me reagim zyrtar: Dy prej tyre shfrytëzuan momentin për të shitur drogë

🕒 E Enjte 11:57 Newsbomb



Aktualitet

Bllokimi i pagave të magistratëve, KALLËZOHET në SPAK ministri Petrit Malaj

🕒 E Enjte 11:40



🕒 E Enjte 11:40 Newsbomb

Gjyqtarët pa lekë, qytetarët në "hall", magistratët bojkotojnë punën, preken Tirana, Durrësi dhe Berati



Aktualitet

Dy zyrtarët e Bashkisë Tropojë u ndaluan pas vdekjes së punonjësit në krye të detyrës, Ndrëçim Gjocaj dhe Gëzim Hasanpapaj do të hetohen në gjendje të lirë

🕒 E Enjte 11:22




Aktualitet

Prej tre ditësh pa gjurmë, familjarët e Saxhide Dishës nga Rrogozhina apelojnë për ndihmë: Na ndihmoni ta gjejmë

🕒 E Enjte 10:58





🕒 E Enjte 10:41

Ngërçi me pagat, Sokol Sadushi në një mbledhje të jashtëzakonshme i drejtohet shtetit: Nuk jemi kundërshtarët tuaj, nga përplasje jonë s'fiton askush



Aktualitet

Pesë ditë në flakë mali i Tërbunit në Pukë, banorët kërkojnë ndërhyrje nga ajri: Është shkumbuar 60% të sipërfaqes

🕒 E Enjte 10:40



Aktualitet

ARRESTOHET çifti i moshuar në Gjirakare, efektivet u gjejnë dy thasë me hashash të tharë në cep të shtëpisë dhe 270 rrënjë të mbjella

🕒 E Enjte 10:23 Newsbomb



🕒 E Enjte 10:21

Tantuan t'i shpëtonin policisë në Korçë, pasagjeri hedh qesen me drogë nga makina dhe shoferi u arratis, përfundon në pranga 31-vjeçari nga Vlora



Aktualitet

Anëtarët e grupit Çopja dhunojnë brutalisht drejtorin e Ujësllësit të Elbasanit, kishte pushuar nga puna gruan e personit që do të hiqte qafe gazetarin Saimir Kodra

🕒 E Enjte 10:07



Aktualitet

Bllokuan kryqëzimet në Tiranë dhe u përplasen me qytetarët, në pranga 15 protestues, tre prej tyre kapen me drogë në xhep (DETAJE)

🕒 E Enjte 10:03 Newsbomb



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.